



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALIQ

Nr. 2319 Prot

Maliq me , 04 / 05 / 2017

KONTRATE

E lidhur sot ne daten 04 / 05 / 2017 midis Bashkise Maliq perfaqshuar nga Titullari Z.Gezim Topciu dhe Bashkimi i Operatorit Ekonomik "G&L" me Nipt L61901013N , me License MK.2933/1 "Per mbikqyrje dhe kolaudim te punimeve te zbatimit zbatimi" me administrator Z.Gramoz Skenda me karte identiteti nr.personal G70629151S, i quajtur me poshte **KONTRAKTUESI**

BAZA LIGJORE

Ligji Nr.9643, date.20.11.2006 "*Per prokurimin publik*", i ndryshuar , Ligji Nr.8402 date.10.09.1998 "*Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit*" Kreu III "*Projektimi , mbikqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve te ndertimit*" Neni 7, i ndryshuar, V.K.M. Nr.68, date 15.02.2001 , pika 2 "*Per miratimin e kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te punimeve te ndertimit*", Udhezimi i K.M. Nr.1 date 16.06.2011 "*Per disa shtesa te Udhezimit Nr.3 date.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit "*

KUSHTET E KONTRATES

**Neni 1
OBJEKTI I KONTRATES**

Mbikqyrja e punimeve ne objektin:

"Rivitalizim i rruges Pendavinj-Pojan -Zvezde"

**Neni 2
KOHEZGJATJA E KONTRATES**


Afati kohor per ekzekutimin e kontrates eshte 3(tre) muaj nga data e nisjes se punimeve ne objekt.
Kontraktuesi duhet te paraqitet ne kantier çdo dite nga data e fillimit te punimeve dhe deri ne perfundim pa shkeputje. Per paraqitjen e mbikqyresit ne kantier do te mbahet proces –verbal nga Kontraktuesi Uleza Ndertim , Perfaqesuesi i investitorit (Bashkia Maliq) dhe Operatori ekonomik "G&L".

**Neni 3
VLERA E KONTRATES**

Vlera e kontrates sipas Ofertes te paraqitur ne tender eshte :

19.500 (nentembedhjetemije e peseqinde)
23.400 (njezetetremije e katerqinde)

leke pa Tvsh
leke me Tvsh



Neni 4
AFATET E PAGESES

1. Pagesa do te kryhet nga Autoriteti Kontraktor pas perfundimit te punimeve.
2. Pagesa do te kryet ne leke Shqiptare ne llogarine bankare te Kontraktuesit.

Neni 5
DETYRIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 5/1
GJATE NGRITJES SE KANTJERIT

1. Te beje Akt dorzimin e sheshit te ndertimit.
2. Te beje Raport per gjendjen faktike te sheshit , perputhjen e projektit me faktin dhe ndryshimet e nevojshme per realizimin e projektit.

Neni 5/2
GJATE ZHVILLIMIT TE PUNIMEVE


1. Te beje kontrollin e materialeve qe do te perdoren ne kantier sipas kerkesave te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.
2. Raport javor per ecurine e zbatimit te punimeve ne perputhje me grafikun e zhvillimit te punimeve.
3. Informacion per kontrollet e ushtruara ne objekt.
4. Kontrolli i punimeve sipas KTZ dhe punimet maskuara, me proces –verbalin perkates.
5. Kontrollin e ditarit te objektit.

Neni 5/3
NE PERFUNDIM TE PUNIMEVE

1. Konfirmon perfundimin e punimeve sipas kontrates se sipermarrjes.
2. Siguron nga sipermarresi deklaraten teknike.
3. Harton relacionin perfundimtar per mbikqyrjen e punimeve.

Mbikqyresi i punimeve duhet te pregatise dosjen per kolaudimin e punimeve jo me vonë se 10 dite nga data e perfundimit te punimeve. Bashkengjitur me relacionin perfundimtar te punimeve duhet te shoqerohet me keto dokumente:

- Projekti i plote i zbatimit.
- Ndryshimet dhe shtesat ne projekt.
- Preventivi i punimeve.
- Situacionet pjesore dhe perfundimtar te pranuar prej tij.
- Procesverbalet e punimeve te maskuara.
 - Per nenshtresat.
 - Per rrjetin e infrastruktures.
- Proces verbali i provave te sistemeve te infrastruktures.
 - Pa ngarkese.
 - Me ngarkese.
- Çertifikatat e cilesise se materialeve kryesore dhe produkteve te gatshme.
- Libreza e masave.
- Ditari i objektit.



- Deklarate teknike e sipermarresit.

Neni 6
PUNIMET NDERPRITEN NE RAST SE:

Autoriteti Kontraktor, Kontraktuesi ose Mbikqyresi i Punimeve bejne shkelje themeloret te kontrates, ose Autoriteti kontraktor ka arsye objektive

Atehere Autoriteti Kontraktor bashkepunin me Mbikqyresin dhe Kontraktuesin duke perpiluar procesverbalet e gjendjes se punimeve ne castin e nderprerjes se punimeve shoqeruar me te gjitha dokumentacionin e disponueshem.

Neni 7

Mosmarveshjet midis paleve zgjidhen ne rrugen e mirkuptimit ,ne rast te kundert zgjidhen ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Korçe, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Kontrata u hartua ne 4 (kater) kopje nga te cilat 3 (tre) i merr Autoriteti Kontraktor dhe 1 (nje) Kontraktuesi.

KONTRAKTUESI
Operatori "G&L"

Administrator
Z. Gramoz Skenda



AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA MALIQ

Perfaqesuar nga
Kryetari i Bashkise
Z. Gezim TOPÇIU

